# DËSHMI ARKIVI

**A-473157**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dua Lipa vallëzon në dasmën e djalit të hallës, feston mes të afërmve në Pejë! \| Top Albania Radio |
| ADRESA | `https://www.topalbaniaradio.com/dua-lipa-vallezon-ne-dasmen-e-djalit-te-halles-feston-mes-te-afermve-ne-peje/` |
| BURIMI | topalbaniaradio.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 08:23:36 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 08:22:30 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1f7753b4db41de0fb4130a6d8286482514c161152ff35f5013d626f783e33cae` |
| TEKSTI | `c800e7ff545c41558079ea67817c1143e581b86f709a05032f2f2d0241cd8f62` |
| PAMJA | `3ef98581f1e79b9f17eff94423836f03387e17d75f638fb65c8b23fbf8fce558` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ba822439b25854df0b99e6572a76d26b5889571958a5ef47bbee066a135e42e1` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `ffa3671555d7ae6cb03bad74ec6398ad3819e03f2270ea6128c9f6d225eb63a8` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ba822439b25854df0b99e6572a76d26b5889571958a5ef47bbee066a135e42e1`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Celebrities Gossip Showbiz

# Dua Lipa vallëzon në dasmën e djalit të hallës, feston mes të afërmve në Pejë!

*Redaksia K*

*27 Shtator 2026*



Dua Lipa është rikthyer në Kosovë për një arsye krejtësisht familjare. Këngëtarja me famë botërore ka marrë pjesë në dasmën e djalit të hallës së saj, Andit, në Pejë, duke iu bashkuar festës së familjes.





**Artistja është parë duk**e shijuar atmosferën e dasmës dhe duke vallëzuar nën ritmet e muzikës tradicionale shqiptare. Pamje nga festa janë shpërndarë në rrjetet sociale, duke treguar një Dua mjaft të çlirët mes familjarëve dhe të ftuarve.

Në një prej momenteve të publikuara, këngëtarja shihet duke kërcyer me të pranishmit dhe duke iu bashkuar festës sipas traditës shqiptare. Në disa pamje të tjera, ajo shfaqet duke mbajtur edhe një gotë mbi kokë gjatë vallëzimit, një veprim karakteristik i atmosferës së dasmave shqiptare.

Kjo vizitë në Kosovë vjen rreth dy muaj pas qëndrimit të saj të mëparshëm, kur Dua ishte në vend për festivalin "Sunny Hill", eventin që ajo organizon së bashku me babanë e saj, Dukagjin Lipën.

Këtë herë, megjithatë, rikthimi i saj nuk lidhet me ndonjë koncert apo angazhim profesional. **Dua** ka zgjedhur të jetë pranë familjes në një prej momenteve më të rëndësishme për të afërmit e saj.

Familja e këngëtares ka origjinë nga Peja dhe qyteti vazhdon të ketë një rëndësi të veçantë për të dhe të afërmit e saj. Prania e saj në dasmë tërhoqi vëmendjen e të ftuarve dhe të publikut, ndërsa fotografitë dhe videot nga festa nisën të qarkullojnë me shpejtësi online.

**Dua Lipa n**uk ka publikuar vetë pamje nga dasma në profilet e saj, duke e mbajtur këtë moment kryesisht në rrethin familjar. Megjithatë, disa prej momenteve të festës janë bërë publike nga të afërm dhe të pranishëm në ceremoni.

Mes angazhimeve ndërkombëtare dhe jetës së saj në qendër të vëmendjes, këtë herë këngëtarja është shfaqur në një rol krejt tjetër: si pjesë e një feste familjare shqiptare, duke kërcyer dhe festuar krah njerëzve të saj të afërt.

## LAJME TË NGJASHME



Dua Lipa surprizon në Pejë, merr pjesë në një dasmë familjare!

1.5 MIN



Dua Lipa arrin një tjetër rekord, kap shifrën e 1 miliard...

1 MIN



Dua Lipa "çmend" fansat me fustanin transparent, krah Callum Turner!

2.5 MIN



Dua Lipa reagon pas vendimit në Hagë! "Liria është fitu me gjakun e dëshmorëve…"

1 MIN




Samsung kërkon rrëzimin e padisë 15 milionë dollarëshe të Dua Lipës?

2.5 MIN

## MË TË LEXUARAT



Nations League, sonte SHQIPERI vs. BJELLORUSI/Ekskluzivisht në DigitAlb!



Aksident në Fushë-Krujë/Përplasen 3 automjete, humb jetën një 19-vjeçar!



Punë e paqëndrueshme dhe pension i hershëm, studimi zbulon lidhjen me plakjen e trurit!



Gjiganti italian i modës Gucci nxjerr në treg atlete "Made in China"!



Tanimë gjërat kanë ndryshuar/Shenjat e zodiakut që më në fund po fillojnë një kapitull të ri të jetës së tyre!



A kaloni shumë kohë ulur? Ja çfarë mund të ndodhë nëse ecni çdo gjysmë ore!



A ju ndodh të shihni të njëjtën ëndërr vazhdimisht? Çfarë mund të fshihet pas saj?



Cindy Crawford përjetoi vite të vështira për djalin e saj?



Madonna tërheq vëmendjen me fotografi provokuese, pozon me reçipeta transparente?



"The Real Rooneys" përballet me kritika? A është jeta e Wayne dhe Coleen Rooney vërtet kaq autentike?

## EDITORI SUGJERON














Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.